

# **OXHAKU**

## **MIHAL GRAMENO**

### **PJESA E PARË**

#### **Krye I**

Më 1821, në kohën e Ali Pashës Shqipëria, dhe më shumë Toskëria gjendeshe në rrëmuje. Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaj, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç’kishin edhe vështronin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.

Asi kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzonjë, duke qenë më parë një qyteti i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kenë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët të cilët ngryseshin të gjallë e gdiheshin të vdekur. Andaj, me të perënduar dielli, mbylleshin nëpër shtëpitë edhe nuk dinin ç’bëhesh natën në qytet.

Nga ky shkak nuk kishin vërejtur që “shtëpia e zezë” prej ca kohe mbante njerëz brenda.

“Shtëpia e zezë”, siç e quanin qytetarët ishte një shtëpi e madhe, ndërtuar me gurë dhe rrethuar më gjithë anët ime avlli edhe fortësia edhe ishte mbanë qytetit pranë kroit të Abdi beut. Prej shumë kohe, kjo shtëpi ishte e pandënjur edhe e shkretuar, të gjithë sa kishin ndenjtur, gjithë atë fat kishin pritur që të shuhen me gjithsej, edhe nga ky shkak kishte arritur të jetë folë e kukumjaçkave edhe e galave, se njerëzia jo vetëm që nuk

guxon të ryjnë brënda, por edhe kur shkonin pranë asaj shtëpie do të faleshin me tmerr, duke iu lutur zotit t'i shpëtonjë edhe t'i mpronjë nga nonjë gjëmë e madhe.

Në të këtilla frikëra gjendeshin korçarët, kur një natë të marsit frynte një erë e marrë edhe dëgjojnë të zbrazura prej pushkësh. Të gjithë mbetnë të tmerruar, se pandeshnin që afrojtë edhe për ata fundi i jetës. Andaj që të gjithë faleshin, duke kërkuar nga nonjë vent të fshehtë për shpëtimin e shpirtit, edhe asnjë nuk guxonte të dalë përjashta që të mësonjë shkakun e pushkëve.

Po sa vinte më shumë dëgjoheshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoheshin edhe zëra njerëzish, të cilët bërtisnin sa muntnin që të vraponin të shuanin zjarrin që diqte shtëpinë e zezë, se ishte shumë frikë mos përhapet zjarri mi gjithë qytet.

Vetëm atëhere njerëzia, si u siguruan që nuk është tjetër rezik përveç zjarrit, të cilin e pandehnin t'ja ketë vënë nonjë njeri mëndjeshkurtër, vraponin me ujë, dhiqelë e sëpata, edhe me çfarë muntnin për të shuar zjarrin.

Po, me t'u afruar pranë shtëpisë së zezë që digjesh, mbetnë të nemitur e të habitur kur vështronin sot krerë njerëzish në dritaret e shëpisë, të cilët u luteshin edhe u kërkonin ndihmë që t'i shpëtojnë mos digjen të gjallë.

Një grua e re edhe e bukur, që dukesh fare mirë në dritare të flagëvet me leshrat e lëshuar edhe të pakrehura, me sy të zgurdulluar, veshur me rrobën e natës si ç'ishte ngritur me tmerr nga gjumi, zgjate duar, duke lutur njerëzinë t'i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqënëqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!

Po njerëzia gjithë mbetnë të shurdhër në blegërimet e në lutjet e kësaj gruaje, mënjanë nga frika e zjarrit që nuk muntnin t'afroheshin, më tjetër anë nga tmerri që

vështronin njerëz në atë shtëpi, të cilën e dinin të pandenjur edhe të shkretuar. Andaj vështronin vetëm që të mos zgjatet zjarri më tjetër shtëpi, duke lënë të brençmit në duart e Perëndisë!

Ah, sa keq është të veshtrosh shpirta që digjen edhe të mos mundësh t'i shpëtosh!

Zërat që brenda pushuan së bërtituri edhe së kërkuari ndihmë edhe nuk dëgjohesh përveç trak-trak! nga drurët edhe nga dhogat që digjeshin, se zjarri sa vinte po përhapte flagët më të gjitha anët, kur dëgjohet pas pakëzë, për të fundit herë, një buçim i math përzjerë me një zë të thellë edhe pastaj bëhet një heshtje e madhe, se çatia me dyshemetë e gjithë ç'kishte shtëpia, ranë të gremisura, edhe zjarri më s'kishte fuqi.

Qytetarët ndenjë të gjithë pranë zjarrit gjer më të gdhirë, për të ruajtur mos kërcenjë nonjë shkëndijë afër, edhe pyesnin njëri-tjatrën në dinte gjësendi që kur rronin njerës në këtë shtëpi po asnjë prej syresh nuk e dinte ç'njerës rronin, që kur kishin ardhur në atë shtëpi, edhe sa ishin. Andaj, me gjithë helmin që ndjenin për ata që u bënë therorë të zjarrit, gëzoheshin më tjetër anë se zjarri i vuri funt asaj shtëpie së zezë, që kishte shuar kaqe njerës, edhe të cilën e nëmëronin si shkakun e gjithë të ligave që ngjisinin në qytet!

## **PJESA E PARË**

### **Krye II**

Pas këti zjarri të tmerruar, po të gjendeshe në krua të Abdi beut, do të vështronje dy njerës që shkonin me vrap të math, duke kthyer ngandonjëherë sytë prapa që të vështrojnë zjarre në digjet.

Siç ishin pshtjellë me gunat e gjata e të zeza, nuk muntnje t'u vëshronje fytyrën, edhe nuk nxirrnin asnjë kuvënt nga goja e tyre, kur me të kapërcyer kruan vërshëllejnë nga një herë.

Me të vërshëllyer, del nga prroi një njeri, i cili hiqte tre kuaj prej kapistalli edhe me të afruar i pyeti:

— A mbaruat punë, o djema?

— Ashtu besojmë që kurrë nuk jemi turpëruar, t'ungjatjeta, bej, — përgjigjen që të dy.

— Andaj edhe unë të zgjodha ty, Sulo, me Rushitin, — thotë beu siç e quanin, — se kurrë s'kam dyshuar për punën e besës tuaj, po thomëni a ini sigur në u doqnë bashkë me shtëpinë, të gjithë sa ishin brënda.

— Për këtë të jini të çkujdesur, — thotë Rushiti, — se neve nuk ikmë gjerë mos pamë me sytë tanë shtëpinë të gremisur edhe të bëhet hi me gjithë sa ishin brënda. Të gjitha lutjet e ulërimat që t'i shpëtojnë njerëzia mbetnë të kota, se asnjë nuk guxonte t'i afërohesh zjarrit, edhe të vinte veten e ti në rrezik që t'i shpëtonjë.

— Nuk më thoni si munt t'i vini zjarre shtëpisë e të mos u ndjejnë të brënçmit?

— O bej, — thotë Suloja, — për neve është mjaft që të na urdhërosh, pa dimë si të punojmë për të tilla punëra. Se si u ngrys, hymë ngadalë në avllitë e, si ranë të flenë e më s'dëgjohesh nonjë zë, forcuam një dritare të një dhome, që s'rronin njerës edhe, duke unjur kurrizë Rushiti, u ngjita edhe hyra brënda, pastaj si një mace ngadalë vajta gjer në katin e dytë; duke përhapur e duke derdhur barut më gjithë anët edhe, si u siguruash që më s'kanë shpëtim, u rëzova në dritare, ku më priste Rushiti edhe që atje i vura zjarre

barutit. E neve duallmë përjashta dhe shikuam zjarrin gjersa u doq dhe u gremis shtëpia me gjith sa ishin.

— Bravo, ore Sulo, edhe Rushit, — u thotë beu; — tani e shoh edhe unë që jo pa të drejtë e hani bukën time, andaj për këtë punë që bëtë sonte dijeni që ju nam për të falur nga një pushkë të artë edhe nga një kalë.

— Të paçim sa malet bëj, — i thonë të dy.

— Tani u hipni kuajve edhe ejani të shkojmë që të arrijmë pa gdhirë në shtëpi, se tani jam i çkujdesur për atë bushtër të bukur që u bë hi bashkë me klyshin e saj, edhe më s'ka t'i prishnjë mëndjen djalit tim, i cili arriu të mos mendohet i kujt bir është! Fuqi kishte në i pëlqente ta marrë si robinjë të rronjë me të, jo të martohet fshehtazi e të ketë për grua një fshatarkë me të cilën anë çnderon Oxhakun. Po tani pa dyshim kur të kthehet nga lufta, edhe të mësonjë për të bukurën që iu doq në zjarr, ka për të ardhur në shtëpi duke kërkuar ndjesë se, po ta vrisnin, atë here do të besonte që ja vrava unë edhe kush e di ç'muntë të bënjë.

Si ndezi çibukun beu, që të tre u hipnë kuajve edhe, të gëzuar, për punën që bënë, muarrë udhën e Perëndimit.

## **PJESA E PARË**

### **Krye III**

Nuk shkojti shumë kohë, kur pa të ikurit të këtyre kalorësve, afrohet një grua në krua duke mbajtur gjësendi në krah. Që në të parin vështrim nuk munte të mos e tmerronte kjo grua, sa do zemër të fortë të kish njeriu, edhe të mos ndjenjë për atë një

hidhërim të math. Se megjithëqë ishte e çveshur dhe e pambuluar, nuk muntnje kurrë ta njihnje prej fytyrës në ishte e re apo nonjë plakë, meqënëqë fytyra e saj ishte e djegur, edhe e zhuritur, leshrat e vetullat për së largu binin erë shkrump, zbathur, lakuriq, sa edhe rroba e trupit ishte e djegur edhe e çjerrë rripa-rripa më shumë vënde, duke lënë vënt t'i duken mishrat.

Po ajo nuk vështronte në ç'gjendje ishte edhe vështronte udhën si pa nonjë të keq, gjersa afrohet në krua.

Me të arrirë atje, lëshon përdhe një gjë të pshjellë që mbante në krahë, edhe vetë hyn që ta laknjë (1), se si dukesh ndjente të djegurë edhe të nxehtë në trup të saj.

Atje qëndroj ti pakëzë gjersa u bë qull nga ujët, kur dëgjon zë foshnje të qajë e të lebetinjë. Ngrihet menjëherë edhe vete merr foshnjën, se nuk mbante në krahë tjetër gjë përveç një foshnje të vogël motmoçar.

Si merr foshnjën në krahë, një e qeshur e pareshtur i çfaqet në buzët e saj, edhe duke lojtur e duke i kënduar foshnjës nani-nani, merr edhe ajo udhën e Perëndimit, në një drejtim ku vështronte më shumë flagëza prej zjarri që diqnin.

Pas fytyrës edhe pas rrobave që kishte mi trup dukesh që kish shpëtuar nga nonjë rrezik i madh, edhe do të thoshe që ishte e prishur mënj, meqënëqë, përveç të qeshurit, asnjë kuvënt nuk nxirrte prej gojës.

Foshnja lebetinte sa munte, po as nuk e dëgjonte t'i apë sisë që të reshtej, po vështronte udhën duke ikur me vrape duke kënduar gjersa arriu në ata zjarre që kishte parë që nga kroj.

## **PJESA E PARË**

## Krye IV

Të lemi pakëzë këtë grua me foshnjën në zjarr, edhe të kthehemi në burim të Cekanit, gjithë atë natë e në atë orë, kur pamë të tre kalorësit edhe gruan me foshnjën, që të vështrojmë një tjetër burrë, i cili dhe ay mbante një foshnje mi supet, duke ikur sa munte me vrap. Nga fytyra edhe ky nuk njihesh, meqënëqë leshrat, mustaqet, turinjtë, rrobat, sa edhe trupi i ishin kaqe djegur, sa me gjithë burrërinë që tregonte për dhembjet e plagëvet që kishte marrë, nuk munte të mbanjë rënkimin.

Me t'arrirë në burimin e Çekanit qëndrojti pakëzë edhe si rrëzoi foshnjën nga supet e pyeti:

— A të pihet ujë, o shpirt i Rustemit?

— Jo, — tha foshnja, që ishte një djalë prej 3 vjeç, po ku më shpie kështu, o Rustem, edhe ku është nëna me Salfën?

Nga këto emra sytë iu mbushnë me lot Rustemit, po që të mos helmonjë djalin e mbante duke thënë:

— Ato mbetnë në shtpi, Rexhepkë, e neve do të vemi në një dasmë, ku ka për të ardhur edhe yt atë, e nesër hipur në kuajt do të kthehemi në shtëpi.

Djali besoj Rustemin edhe u gëzua që do haset me t'anë, edhe ka për të hipur mi kalë, andaj si lau sytë edhe piu pakëzë ujë në burimet, Rustemi hodhi djalin mi sup edhe muarnë udhën e Pogradecit.

Po atëhere zuri i gjori Rustem të ndjenjë dhembjet e mbëdha nga plagët, se tani iu ftohen edhe nxirrte rënkime nga zemra.

Djali, i cili pandehte se u loth, i thotë ta zbresë prej supesh që të vejë më këmbë.

Kur e ndjeu Rustemi vetem që nuk ka shpëtim, zuri të vraonjë këmbët më shumë, duke mentuar të arinjë sa më shpejt në një fshat, ku qëllonte të siguronjë djalin gjer të haset me t'anë në një mik të besës, me të cilin kishte lidhur vëllazëri për jetë, po nuk mundi të mbushnjë këtë qëllim për të cilin kishte marrë ato të djegura. Se dhëmkat sa vinin po i shtoheshin, fuqia e la, këmbët iu prenë, edhe atëhere i pashpresuar jo për veten e ti, po për djalin, mblodhi të fundit fuqi që i kishin mbetur edhe bërtiti sa mundi. Po kur vështron që asnjë zë s'i përgjigjet, ngreh sytë ndë qiell, duke lutur Perëndinë që ay ta ketë nën mprojtjen këtë djalë iqë mbetesh i varfër edhe pashpresje ndë jetë!

Pushoi duke puthur djalin edhe kësisoj mbylli sytë në mes të udhës!

## **PJESA E PARË**

### **Krye V**

Që të mësojmë cilët ishin këta njerës edhe ç'lidhje kishin midis tyre, duhet të kthehemi në krua të Radanecit, aty pesë muaj përpara këti zjarri të tmerruar, në një natë të vjeshtës, kur një shi i pareshtur derdheshe si lum, që të vështrojmë katër kalorës që shkonin s'andejmi. Që të katër ishin pshtjellë me gunat e gjata aqë shumë, sa nuk linin vënt për të vështruar fytyrën. Dy prej syresh, që vinin prapa, dukeshin të mbajnë gjësendi në krahë se duke shkuar unjnin gjithnjë sytë të vështrojnë në gunë. Si u afruan në Radanec, zbritnë të gjithë nga kuajt edhe i lëshuan në lejë të tyre (2), pastaj muarnë anën e qytetit, duke mos kuvënduar asnjë fjalë, gjersa arrinë ne "shtëpia e zezë". Me të qëndruar përpara portës, hodhën sytë më të gjitha anët, edhe si sigurohen që s'i vështron njeri, një nga ata nxjerr një kyçe dhe si hapën portën, rynë brënda në avlli, pastaj e



mbyllën me hekura. Si rynë brënda në shtëpi, ku i shpinte një nga ata i cili dukesh të dijë mirë fare të ndënjurat e kësaj shtëpie, ndezë, një dritë meqenëqë dritaret ishin mbyllur me kanata kaqë lirë, sa që përjashta kurrë s'muntnin të vështronin dritën.

Atëhere njiheshin si nxuar edhe gunat që këta ishin dy burra, dy gra, një djalë i vogël prej 3 vjeç edhe një vashë foshnje, të cilët i kishin sjellë më krahë gjer atje.

Shtëpia ishte si jashtë edhe brenda ndërtuar me mjeshtri të madhe, të bukur e të sigurtë për nonjë rrezik, se kurrë nuk munt një i huaj të rynjë brënda. Me të dy katet e shtëpisë ishin nga dhjetë dhoma shtruar fort bukur me qilime kombiare edhe persane të vlefte, e me gjithë ç' duheshin për një shtëpi të madhe e të begaçme.

Si shëtitnë gjithë shtëpinë anëmbanë, zgjedhë një dhomë për të ndenjtur edhe i thotë njëri tjetrit burrë:

— A je i sigurtë Rustem që nuk të gjurmuan e të të pikasen njerzij' e tim eti kur solle gjithë këto shtrofka aty edhe që na zgjodhe këtë fole për të ndenjtur.

— Si urdhëron, bej, — thotë Rustemi; — jam kaqë sigur sa asnjë dyshim nuk më shkon nëpër mënt, se unë gjithnjë, sa herë që vinja aty, merrnja masë së pari që të mos më vështronjë njeri. Andaj ju lutem të jini të çkujdesur për këtë edhe të mos kini nonjë frikë, se kurrë do të mos shkonjë ndër ment e të na gjejnë këtë të ndenjtur. Pastaj më tjetër anë neve do të mos dalim nga shtëpia ditën që të na vështrojnë, po vetëm natën kur gjithë njerëzia gjenden në gjumë.

Ashtu qoftë, Rustem, — thotë një nga gratë, — po unë më shumë se kurdoherë sot ndjenj një frikë në vete time, edhe më tregohet që një e madhe e keqe na ka për të gjetur në këtë shtëpi.

— O Vahide, shpirt i dashur, — thotë Beu, — mos shko nëpër mënt të këtilla mendime të liga, se për Perëndi më copëton zemrën! Kur sot na lith edhe më shumë një tjetër dashuri për gjithnjë, tinë të kesh tmerr! Beto hem për kryet e të shtrënjtit tonë Rexhepkë që vetëm kur të kaprcejnë përmi mua të vdekur, atëhere munt të të ngjasë nonjë e ligë, se përpara teje Vahide nuk bësonj njeri në botë.

— O Maloja im i shtrenjtë, kurrë s’kam dyshuar për dashurinë tënde, të cilën e ke treguar me të tepër, se tinë për mua shkele Oxhakun edhe dashurinë e prindërve. Andaj për veten time nuk helmohem çfarëdo që të më ngjasë, po për tynë, Malo, edhe për Rexhepkën tonë kam frikë mos pësojnë gjësendi dhësi, se prindërit me kohë, megjithëqë mbajnë shumë në Oxhak, do të na ndjejnë edhe të na përqafojnë

— Me emrin e Zotit asnjë qime s’kemi për të cënuar, edhe shpresonj që paskëtej të rrojmë në fatbarsi fëmijën e tyre.

— Këtë mos e thuaj, o Malo, se kurrë do të mos bindet një Rushan Be që të quajnë edhe të marrë në shtëpi nuse për djalin e tij, një vashë të popullit, po ay ka për të kërkuar humbjen time prej faqes së dheut, e vetëm Zotit i arthtë keq e i mbajtë dorën për Rexhepkën tonë!

— Sa për Rexhepkën, Vahide, ja ku kemi Rustemin e besës, i cili e ka për të mprojtur nga çdo rrezik, me jetën e ti.

— Ashtu është, Bej, — thotë Rustemi; — se përpara teje e të dashurve të tu nuk kujtonj as grua, as fëmijë, edhe kurdoherë jam gati të behem theror se jetën ty ta detyronj!

— Rustem, për kokën tënde e të Saftës, mos kujto të shkuarat, se unë atë që bëra për ty e bëra vetëm për një të drejtë!

— Jo, Bej, nuk është ashtu; se të drejtën sot fort të pak janë si Malo beu që ta mprojnë edhe, sikundër që më ashtu edhe unë vdes për tynë edhe për fëmijën tënde!

— Perëndia të falte gjithë të mirat, o Rustem, se tinë për mua do të jesh më shumë se një vëlla rne dashurinë edhe besën që më tregon, se tani vete i çkujdesur për Vahidenë edhe për Rexhepkën në luftë.

— Të vini e të ktheji shëndoshë, Bej edhe me emrin e Zotit shpresonj të hasemi në këtë shtëpi pa cënuar asnjë qime .

Ora afrojtë për t’u ndarë. Maloja duhesh të shkonjë se e prisnin shokët për në luftë, se asi kohe kishte ngritur krye Greqia.

Po cili munt të tregonjë atë ndarje që të copëtonte zemrën!

Se lotët e të puthurat nuk merrnin të sosur kurrë, edhe asnjë nuk kuxonte të përçfaqej se paramendonin që vallë do të përçafosen edhe tjetër herë!

Kur dëgjohet kaposhi, Maloja forcon zemrën edhe, si puth Rexhepkën, i cili s’i ndaheshe nga krahët, puth edhe Vahidenë, duke e forcuar me fjalë që për së shpejti do të kthehet edhe të mos ndahet kurrë, merr armët edhe shkon! Vahidja, me të shkuar Maloja, zuri vajnë e blegërimat, se një gjëmë i tregohesh që do ta ndjekë, andaj nuk dëgjonte Rustemin, i cili kërkonte ta qetonjë e t’i nxjerrë tmerr që kishte nga Rushan beu.

## **PJESA E PARË**

### **Krye VI**

Maloja, me gjithë që kërkonte të dëftehesh i çkujdesur, ishte fort i brengosur, se ay e njihte ca më mirë t’anë që kish për të kërkuar humbjen e Vahidasë me Rexhepkën, se

për këtë qëllim e dërgonte në luftë për të mos i shpëtuar dot ata. Po Maloja, më mirë priste vdekjen, sa rrojtjen pa Vahidenë, për të cilën kishte një dashuri të patreguar dhe me të cilën ishte martuar fshehurazi.

Vahideja ishte vashë prej populli, e bija e Shaqirit nga Batha, një fshat i vogël që ishte nën urdhër të Rushan-Bej Frashërit. Prindët e saj ishin njerës fort të mirë, shtëpresë (3), edhe ata më të pasurit e fshatit. Andaj kurdoherë që të vinin njerzit e Rushan beut për të mbledhur drithërat edhe pagimet, do të hiqnin në shtëpi të Shaqirit.

Si iu rritnë fëmija, Rushan beut, kërkonte të mësonjë fëmijën e ti që të veshtronjë vetë punërat. Edhe për këtë ndau secilitdo nga tre katër fshatra, se Rushan beu ishte një prej të begaçmet edhe më të dëgjuarit Oxhakë të Shqipërisë, e kishte më shumë pyeje, male, çifligje, edhe fshatra nën urdhërim, duke ndenjtur vetë në Prashër ku kishte një pallat të math e të bukur.

Kur mbushi njëzet e një mot Maloja i cili ishte i treti djalë, i dha edhe ati katër fshatra, në rreth të cilëve ishte edhe fshati i Shaqirit.

Maloja në atë vërsë ishte ay më i bukuri nga gjithë djemtë, mustaqja sa i kishte dërsirë, një vetullzi, hundën e tretur, edhe një gojë aqë të bukur sa edhe të ëmbël që, kur kuvëndonte, të fitonte zemrën për gjithnjë. Po si nga bukuria, ashtu edhe nga mënyrat edhe nga karakteri nuk kishte shok: i urtë, shpirtmirë, edhe fort i drejtë. Andaj të gjithë u gëzuan kur mësuan që do të kenë Malon për zot, edhe me të vërtet nuk u gënjyen, se pas pak kohë gjithë ata fshatra zunë të lulëzojnë edhe të përparojnë, duke mos patur tani njerës të huaj, dërguar prej Rushan Beut, të cilët kërkonin t'ju rjepin edhe këmishën e trupit.

Maloja me të vajtur për të parën herë në shtëpi të Shaqirit, ku e pritnë me nder të math, edhe e gostitnë me sa muntën më mirë, u godit në zemër me të pjekur sytë me të Vahidesë, vashë e Shaqirit.

Se jo Maloja vetëm, po cilido që të ishte nuk munte të mos goditësh nga bukuria e Vahidesë, se Zoti i kishte falur gjithë dhuratat e mira e të bukura.

Nga bukuria shkonte edhe të bukurën e dheut me ato leshra të dredhura, ngjyrë gështenjë e të gjata gjer në thembrat e këmbëve, sytë bojë qielli, me të cilat të zotëronte zemrën kur të vërtite qepallat, gojën e vogël, rrethuar me buzë të kuqe nën të cilat dukeshin dhëmbët si të fildishtë, hundën të derdhur, faqet të kuqe si burbuqe trëndafili, këmbët e dockat të vogëla, mbuluar me lëkurë si kadifeja, si edhe trupi i derdhur si selvia. Po edhe nga mënyrat edhe karakteri nuk kishte shoqe, se kishte marrë nga prindërit të ditur, të mirë e të urtë, shtërpresë, zëmërqëruar, e kështu kishte fituar dashurinë e gjith fshatit edhe ishte gazi i prindërve.

Andaj Maloja, me të parë këtë vashë, nuk mundi të mbahet e të mos habitet, që vështron për të parën herë kaqë bukuri edhe këtë mënyrë në një vashë fshatarake, duke shkuar nër ment që do të jetë fati kur t'i shpëtonjë Vahideja për grua.

Më tjetër anë, edhe Vahidesë me të përpjekur sytë me të Malos një e skuqur iu çfaq mi fytyrë, edhe unji kryet, duke mos duruar sytë e Malos se i diqnin zemrën. Habitesh vetvetiu e gjora vashë ç'të jetë ajo e dredhur edhe e rrahur në zemër, se kjo s'i kishte ngjarë kurrë gjer ahëre, edhe deshte të mërgonjë këto mendime. Po ishte vonë se shkëndija në një sekundë ishte rrënjosur kaqë shumë, sa zjarri i përvëlonte zemrën,

Dolli përjashta në oborr, që era e natës t'i ftohë e t'i mërgonjë këto mendime të kota, se mentonte që për atë ishte e prerë ajo shpresë, meqënëqë kurrë nuk mundet të

arrinjë grua e Malos, i cili ishte i biri i Rushan beut, një prej më të mbëdhenjtë oxhake të Shqipërisë edhe nëmëroheshe si një mbret në ata vënde.

Po dashuria e zemrës e bëka njerme të harronjë detyrën që duhet të ketë për Oxhakun edhe për prindët, si edhe çfarëdo tjetër dashuri. Andaj Maloja, si u ngrit nga tryeza, ku nuk vuri gjësendi në gojë si edhe Vahideja, u hoq në dhomë të ti për të fjetur, po gjumi nuk iu afrua natën, edhe dërmohëshe në shtrat, duke u mentuar me çfarë mënyrë t'u tregonjë prindëve edhe t'i bintnjë për këtë martesë, pa të cilën jetën nuk e deshte,

Në mëngjes u ngrit si u gdhi i dërmuar edhe, kur përgatitnë sherbëtorët kuajt për të shkuar, mori një dëshnim (4) edhe thërret në dhomë prindët e Vahidesë, të të cilëvet u tregon qëllimin.

Ata, me të dëgjuar këtë çfaqje të Malos, mbetnë të habitur edhe të nemitur se nuk guxonin të përgjigjen, jo se nuk' u pëlqente kjo martesë, po meqënëqë mentonin se s'ka për të ngjarë kurrë që një Rushan bej të bindet e të unjet kaqë poshtë, sa të marrë nuse për të birë një vashë fshatarake. Andaj, Shaqiri i lutet të mërgonjë këtë qëllim edhe të mos ua çfaqnjë prindërvet se atëhere do të ishte liksht për ata, të cilët ishin sigur që do t'i humbasë prej faqes së dheut me të mësuar për këtë martesë i ati.

Maloja nuk dëgjonte këto fjalë, po dëgjonte zemrën, andaj u thotë të përgatiten se për së çpejti do të kthehet me lejë e pa lejë të prindërve që ta marrë Vahidenë për grua, edhe si hipnë mi kuaj shkuan për në Frashër.

## **PJESA E PARË**

### **Krye VII**

Me të vatur në shtëpi, kërkonte kohë që t'i tregonjë së pari s'ëmës për këtë qëllim edhe ajo t'i thotë t'et. Po ajo ditë nuk vinte, meqënëqë Maloja kishte turp e nuk kuxonte të hapte gojën të tregonjë dashurinë që kishte për Vahidenë. Andaj dita me ditë fishkëshe si një lule në kopsht!

Se në jetë nuk paska brengë më të madhe se e dashurisë që të tretë më këmbë edhe të thëthin gjakun si gjarpëri.

Prindët vështronin ndryshimin e math të Malos, po nuk kuptonin shkakun për të cilin rrinte gjithnjë i brengosur, i helmuar, i pangrënë edhe i mërguar nga çdo dëfrim e kuvend në fëmijë, se ay kërkonte gjithnjë të gjendet vetë.

Në lutjet e pyetjet e prindërve që t'u tregonte shkakun, u përgjigjeshe që nuk kish gjësendi, po kur pa që kjo heshtje do të vdesë dëshmojti t'i thotë s'ëmës për këtë dashuri që i hiqte zemrën, duke drojtur t'i dëftenjë vashën e fshatin.

E ëma, me gjithë që mbante edhe ajo në Oxhak shumë, u bint më së fundi kur dëgjoji Malon që prej kësaj martese mbante fati i jetës së ti, dhe iu zotua që do të kërkonjë të bindnjë edhe t'anë.

Po Rushan beu, me të dëgjuar këtë lajme, u ckuq si karavidhja edhe, i tmerruar, ngrihet prej vendit, duke vënë dorën në armët si për t'u mprojtur nga nonjë rrezik i math, edhe i përgjigjet gruas:

Më i kënaqur do të jem të vështronj Malon të shtrirë e të vdekur, sa t'i ap lejë të martohet me një vashë fshatarake, për të cilën pa turp hap gojën të ma lëvdosh!

Sytë iu zgurdulluan edhe kush e di çmunte të bënjë në atë sekundë po të dinte vashën, andaj thotë:

Gëzohem se nuk është vonë edhe koha e humbur, se kam për të marrë masë që ta mësonjë cila vashë është ajo që m'i prishi mëndjen djalit, edhe do t'i tregoj unë si murit të arrinjë nuse e djalit të Rushan beut!

Me të mësuar Maloja përgjigjen e t'et nuk priti të shkonjë shumë kohë, po që të nesërmet ngrihet edhe shkon në Bathë, ku martohet fshehtazi me Vahidenë, të cilën e mori edhe e shpuri për siguri në një fshat të huaj, ku nuk i njihte njeri, duke lënë Rustemin të besës bashkë me gruan edhe atje lindi Rexhepkën.

Kësisoj rrojnë tre vjet, duke pritur që koha të ndreqnjë punërat, se Maloja besonte që, më së fundi, do të bindet i ati a do të mos rronjë njëmijë vjet edhe atëhere do të jetë i lirë të bënjë si të donjë. Po Rushan beu, zuri të marrë masë kur vështronte që Maloja nuk deshte të martohet me vashat që i thoshnin ata edhe kjo e vuri në pendim (5) më shumë.

Andaj thërret mënjane Sulon edhe Rushitin që i kishte të besës edhe u beson qëllimin e fshehtë që të kërkojnë e të mësojnë ku humbet kohën Maloja, që i pëlqente gjithnjë të vejë nëpër fshatrat. Edhe nga ata mëson që Maloja, jo vetëm është i martuar po ka edhe një djalë.

Kjo lajme ishte për Rushan bëjnë më shumë se një plumb që t'i godite zemrën: sytë i lëshonin shkëndija edhe, pa vonuar, i urdhëron për humbjen e kësaj gruaje bashkë me djalin, po me nonjë mënyrë që të mos besonjë Maloja që erdhi nga i ati kjo gjë.

Këta dy gjakatarë që ishin lindur vetëm për të liga edhe për gjak njeriu, u gëzuan për këtë shumë edhe, duke marrë përsipër humbjen e Vahidesë me djalin, shkuan në atë fshat edhe hyjnë një natë fshehtazi në shtëpi të saj, kur Maloja gjendesh në Frashër. Por Perëndia ishte mpronjë përmi Vahidenë me djalin e saj edhe i ruante nga të ligat, andaj në çastin kur forcuan dritaren që të hyjnë, Vahideja u zgjua edhe, posa i pa këta njerës,



nxjerr një bërtim të thellë. Me të dëgjuar Rustemi bërtimin, vrapon në dhomë me shpatë nxjerr për të mprojtur atë.

Kur panë kusarët, siç i pandehnin të jenë, që çdo shpresje është e kotë, zbrasnë pushkët përmi ta, po për fat asnjë nuk godatnë.

Në dritë të pushkëve njojnë që ata nuk ishin kusarë, po shërbëtorët e Rushan Beut, edhe që atëhere Vahideja mori një frikë të madhe edhe një tmerr, se e dinte që nuk shpëtonte nga thonjt e Rushan Beut. Kur mësoi Rushan beu që shpëtuan pa vrarë, u mentua që rre tjetër mënyrë t'i humbasë, edhe për këtë qëllim i thotë Malos të përgatitet që të shkojnë në luftë se asi kohe ishte ngritur për liri Greqia.

Maloja i njihte qëllimet e t'et, andaj urdhëroi Rustemin për tjetër të ndenjtur të fshehtë edhe ay, duke ditur “shtëpin e zezë” të Korçës, ku kishte ndenjtur si shërbëtor, shpuri së pari shtrofkat (6) edhe ç' duheshin. Pastaj vanë edhe vetë, sikundër i pamë, për siguri në këtë folë.

## **PJESA E PARË**

### **Krye VIII**

Shkuan dy tre muaj pas t'ikurit të Malos në luftë, edhe asnjë shënim nuk dukesh që t'u ketë mësuar nonjë njeri këtë folë kaqë të fshehur edhe të tmeruar nga qytetarët.

Po spiunët e Rushan beut nuk kishin tjetër punë, përveç të gjesdisin me të gjitha anët, duke mos lënë katund e qytet, për të mësuar folenë e Vahidesë, duke ndryshuar rrobat e duke bërë çfarëdo tregëti gjer sa arrinë në Korçë.

Atje nuk lanë vër' e vërushkë po me gjithë pyetjet edhe vërimet (7) që bënin, nuk mësuan gjasendi. Andaj të pashpresuar dëshmojnë të shkojnë gjetkë, kur një mbrëmje posa ishte ngrysur, e njerëzia pa mbyllur nëpër shtëpitë, vështrojnë një njeri të huaj pshtjellë me një gunë të gjatë, që tregëtonte në trek.

Ky njeri u bëri një vërejtje të veçantë edhe, duke mos e lënë nga sytë, e gjurmuan gjersa hyri te “shtëpia e zezë”, se nuk ishte tjetër, përveç Rustemi, i cili delte ngandonjëherë për të tregëtuar, ngrysur kur njerëzia ishin fort të rrallë përjashta.

Të nesërmet u lajmëruan nga fqinjët që ajo shtëpi ishte e pandënjur prej shumë kohe, edhe kjo i siguroi më shumë që atje kishte folenë Vahideja. Andaj pritnë sa u ngrysur dhe rynë në avlli, q'andëj panë Vahidenë me djalin edhe sherbëtorët, me anë të një vërejtje (8) të dritares.

Të gëzuar e të kënaqur për të gjeturit e Vahidesë, shkuan në Frashër edhe lajmëruan Rushan Beun, i cili hidhej nga gazi për këte sihariq; të nesërmet u kthyen në Korçë edhe i vunë zjarre “shtëpisë së zezë”, duke besuar që bashkë me shtëpinë ishin djegur të gjithë të brençmit.

## **PJESA E PARË**

### **Krye IX**

Po nuk ishte vërtet siç pandehnin ata e gjithë njerëzia, se kur panë të brençmitë që nuk shpresojnë nonjë ndihmë a shpëtim që përjashta, Rustemi i cili ishte betuar të zot për Vahidenë edhe për Rexhepkën që t'i kërkonjë nga ay, dëshmojtë për shpëtimin e tyre

edhe, në mes të flagëvet, vrapoi në katin e dytë, ku flinte gruaja e tij për siguri me Rexhepkën edhe me Saftën e vogël, e cila ishte vashë e tyre.

Pa vonuar, rrëmben Rexhepin në krahë edhe e nxjerr në avlli, pastaj kthehet që të shpëtonjë edhe të tjerët, po ishte më kot, se zjarri ishte përhapur më shumë edhe flagët e tymit s'e linin ngjitet përsëri. Andaj kërkonte Vahidenë, të cilën e kishte lënë në katin e poshtëm, duke lënë gruan edhe vashën e tij në duart e Perëndisë!

Gjithë kërkimet e bërtimet që të gjejnë Vahidenë mbetnë të kota, se ajo më një anë prej frikës mos i digjet djali, më tjetër anë e tmerruar kur vështronte rrezikun e zjarrit, humbi mëndjen. Edhe e prishur menç ngjitet e merr në krahë Saftën, të cilën e pandehte të jetë Rexhepi i saj, e në mes të flagëve rrëzohet edhe shkon, e zhuritur, me Saftën në krahë.

Atëhere Rustemi i pashpresuar që nuk mundi të shpëtonjë Vahidenë, merrë Rexhepin mi sup, megjithëqë ishte i përvëlur, edhe shkon me vrap, që pa vdekur të siguronjë djalën në një mik besnik, me të cilin kishte lidhur vëllazëri, po nuk mundi ta mbushnjë këtë qëllim se ra i vdekur në mes të udhës.

Këtë funt të tmerruar mori “shtëpia e zezë” me burrërinë që bëri Rushan beu, duke mbuluar për gjithnjë gruan e Rustemit në gërmadhat e shtëpisë, kurse Rustemi u bë theror për shpëtim të Rexhepkës së shkretë, që mbeti udhës pa nonjë shpresje, edhe më tjetër anë Vahideja e prishur menç me të voglën Saftë, muarrë arratinë!

## **PJESA E DYTË**

### **Krye I**

Pesëmbëdhjetë vjet pas këti zjarri të tmerruar edhe pas vdekjes së Ali Pashës zuri të jetë qetësi mi gjithë Toskërinë edhe Qeveria dërgoi për të parën herë një kajmekam në Korçë. Sepse pas rënujave të shumë katundeve e qyteteve Korça u madhua, se më të shumë e njerëzisë të ikur qëndruan në Korçë, e cila u pëlqente, edhe dita më ditë lulëzonte edhe përparonte në mbrothësi.

Kajmekami ishte një plak i ndjerë, me leshrat e mjekrën të gjatë e të thinjur si dëbora, i thatë e gjithë zhubra suratin, një fytyrë shënjtë, fort i urtë dhe i drejtë. Andaj gjithë qyteti e nderonte edhe e dëgjonte shumë. Nga versa dukesh të ish 70—80 vjeç, po psherëtimet, që hiqte gjithnjë, tregonin që kishte vuar shumë në jetë të vet. Nuk kishte me vete përveç një vashë fort të bukur edhe të urtë prej 16 vjeç me emrin Manushaqe, të cilën e donte shumë, një shërbëtore, edhe një grua që e mbante mbyllur në shtëpi gjithnjë, meqënëqë ishte e prishur menç. Andaj njerëzia, duke mos ditur nga ç'vënt e cilët ishin, thoshnin që e prishura mënj ishte gruaja e kajmekamit edhe vasha, e bija.

Nën urdhër i kishin dhënë kajmekamit një ofiq për punërat e mbretërisë me emrin Zëmbak, një djalë fort i bukur, i urtë, i nderçëm, edhe i sjellë.

Kajmekamin që atë ditë kur e pa, për të parën herë, e zuri një dobësi e një dashuri e madhe për këtë djalë. Andaj e merrte gjithnjë në shtëpi edhe e mbante në tryezën, duke qëlluar një gjë në mëndjen e ti.

Zëmbaku ishte djalë i varfër, i rritur në fshat edhe, që në vogëli kur mbushi 15 vjeç, hyri në ushtëri për të cilën i kish kënda. Me trimërinë edhe me urtësinë kishte fituar në pak kohë dashurinë e të mëdhenjve edhe të shokëve. Andaj përparoi shpejt në shkallë të bukës (9) edhe e dërguan në Korçë për më të madh mi ushtarët.

Po edhe djali gjithë si kajmekami nuk ishte i lumtur edhe i kënaqur prej kësaj bote, megjithëqë pritmja i nënqeshte, se me të mbetur vetëm, një brengë e madhe e një helm i zotëronin zëmërën, e duke psherëtitur qante si ndonjë foshnje.

Në Korçë gjeti pakëzë prehje në shpirtin e ti pranë kajmekamit, për të cilin me të hasur kishte zënë edhe ay një dashuri prindërije, edhe më shumë për të prishurën menç, që i thoshnin Flagëtare, meqënëqë i pëlqente gjithnjë zjarri me flagë shumë.

Po edhe Flagëtarja nuk munte të mbahesh sa herë që të vështronte Zëmbakun të mos këcente nga gazi e duke e pushtuar, e puthte në ballë, po e gjora nuk munte të nxjerrë asnjë kuvënt prej goje.

Sa për Manushaqen, ishte mjaft një e përpjekur me sytë e Zëmbakut që të çkuqenë të dy, se magniti i lidhi zëmrat në një çast, duke hedhur shkëndijën e dashurisë. Po kjo dashuri ishte e fshehtë, edhe Zëmbaku e nderonte si një motër, se kurrë s'e shkonte nër mënt që të arrinjë burri i asaj që ishte vasha e kajmekamit.

Po dashuria, sa vinte shtohësh në zëmrat e të dyve. Andaj kajmekami i kënaqur, vërente këtë dashuri, edhe e thërret një ditë Zëmbakun në dhomë veçan edhe i thotë:

— Ore bir, gëzohem që të pruri fati këtu e të të njoh unë, meqënëqë kisha nevojë për një djalë si ty. Edhe sot besonj që qëllimin që kisha mentuar për tynë që kur të pashë, pa nonjë ndalim do ta mbush, se e kuptova që ti ke dashuri për Manushaqen edhe të kam për të bërë dhëndër.

Zëmbaku, i turpëruar për të çfaqurit e dashurisë që s'e shpresonte kurrë, u prek, edhe nga gazi i math që ndjente gjunjëzoi përpara kajmekamit edhe i puthi dorën. Po ay gaz përnjëherësh humbi prej fytyrës, duke u vendosur në një brengë të madhe, edhe i helmuar i thotë:

— Perëndia ju falte jetë të gjatë e gjithë të mirat e dheut, po unë nuk e meritonj nderin e math që më bëni!

Kajmekami i habitur për këtë përgjigje e pyet:

— Cili është shkaku që të ndalon për këtë martesë?

Atëhere I thotë që vërtetë quhem Zëmbaku i Demkës, po unë jam i varfër, duke mos njojtur as atë, as nënë e vetëm Demkën e Xhemilen, gruan e ti, të cilët më kanë rritur si djalën e tyre e më kanë dhënë emrin.

Duke psherëtitur e duke qarë mbuloi suratën edhe thërriste prindërit që s'i njihte.

Kajmekami fort i helmuar për këtë histori që dëgjonte, zuri të qanjë edhe ay, duke i thënë Zëmbakut: Mos u helmo, ore bir, se mundet kështu ishte shkrojtur fati yt, se edhe imi është më i tmerruar nga i yti. Edhe meqënëqë na lith gjithë ay fat, unë duke mos patur fëmijë, do të të jap emrin tim që të mos shuhet e të bëhesh burri i Manushaqes, se edhe ajo s'është vasha ime, po e kam rritur si tynë Demka. Andaj dua të bashkonj dy zemra të drejta e të qëruara që të shkonj pleqërinë pranë juve.

Zëmbaku, habitesh vetvetiu për këtë të ngjarë, edhe iu qetua shpirti se nuk ishte vetëm ay i varfër në botë, po edhe Manushaqja, të cilën e pandehte të jetë e lumtur. Andaj dëshmoi të lithnjë jetën me Manushaqen.

## **PJESA E DYTË**

### **Krye II**

Neve e lamë Rustemin të vdekur në mes të udhës me Rexhepkën pushtuar në krahë edhe e dimë që, pa dhënë shpirtin, bërtiti njëherë sa mundi.

Këtë bërtim e dëgjuan dy udhëtarë, një burrë e një grua që vinin nga Korça për në fshat të tyre, po s'i dhanë ndonjë vëre, duke pandehur që nonjë bari bërtiti për të trëmbur ujqit, vetëm kur u afruan pranë, dëgjuan zë prej foshnje me blegërim.

Foshnja qante se kërkonte të çkëputet nga krahët e Rustemit, po ishte e kotë se nuk kishte fuqi, edhe Rustemi ishte bërë kërcu e nuk dëgjonte të qarat, e kish pushtuar në krahë si për ta mprojtur nga nonjë rrezik.

Udhëtarët mbetnë të tmerruar me të vështruar një të vdekur të ketë një foshnje. Andaj, si lëruan djalin prej Rustemit, e pyetnë cilët ishin edhe nga ç'vënt vinin.

Djali, i cili ishte 3 vjeç, duke mos ditur t'u përgjigjet se nuk dinte gjësendi, edhe më shumë nga tmerri tani qante më shumë. Andaj u helmuan edhe e muarnë me vete duke i thënë burri gruas:

— Zoti na pruri këtë gaz në pleqëri, se neve nuk kemi fëmijë, andaj ta ritim edhe të mos tregojmë që e gjetmë, se pastaj na e marrin prapë.

Si e muarën djalën më krahë dhe e lanë Rustemin të vdekur udhës, shkuan në fshat të tyre, i cili ishte Malaveci, edhe me të gdhirë arinë në shtëpi, duke e qojtur djalin Zëmbak.

Djali, të cilit do t'i themi Zëmbak tani e tutje, qau sa qau si foshnje, po pastaj heshti edhe u mësua në shtëpi të Demkës e të Xhemiles, të cilët e përkëdhelnin me gjithë të mirat edhe e donin si djalin e tyre të vërtetë.

Zëmbaku me të rritur besonte edhe ay që ata ishin të vërtetët prindër edhe i donte shumë. Ishte ay më i urti nga gjithë djemt e fshatit edhe më i bukuri. Kur u madhua e dërgonin prindët ne hoxha të mësonjë, të lëçitnjë, për të cilën e kish kënda. Edhe gjer në

vërsë 12 vjeç asnjë shënim nuk dukesh që të ketë mësuar gjësendi djali për lindjen, kur një ditë kthehet nga hoxha i helmuar edhe duke qarë në shtëpi.

Nakari është nga të ligat ajo më e madhja gjë, edhe më të shumat e grave nga nakari që kishin për Zëmbakun e Demkës që përparonte në të gjitha, u tregojnë fëmijës që Zëmbaku është i varfër edhe i rritur vetëm prej këta prindër.

Ishte mjaft sa të mësojnë fëmija që t'i thonë të nesërmet ne hoxha për lindjen e tij, duke qeshur me atë e duke thënë njëmijë fjalë të ndryshme. Zëmbaku i gjorë më s'i mbante dot lotët, edhe i turpëruar për këtë të çfaqur, kthehet duke qarë në shtëpi që të lajmërohet në është e vërtetë kjo gjë.

Prindët që nuk e shkonin këtë çfaqje nër mënt, mbetnë të nemitur e të habitur kur dëgjuan djalin t'u tregonjë, duke qarë, shkakun, se ata pandehnin që qante nga shaku i hoxhës, a i nonjë djali që ta ketë qërtuar.

Për ata kjo e çfaqur ishte më tepër se rrufeja që t'u binte mi krye, meqënëqë gjithë gaz i tyre ishte Zëmbaku, të cilin me kohë e kishin harruar që e gjetnë edhe u dukesh të besonin që është vërtet i tyre. Po tani nuk kishin ç'të bëjnë e duhesh t'i tregojnë të vërtetën. Andaj, duke përkëdhelur djalin, i dëftejnë si e gjetnë.

Atëhere, djali zuri të mendohet thellë e të sjellë pakëzë nëpër mënt sikur ishte në një shtëpi bashkë me dy gra edhe nje burrë e një foshnje të vogël. Po pastaj shkuan s'andejmi e vanë gjetkë, në një natë hipur mi kuajt.

Kaqë gjë sillte nëpër mënt si edhe për të vvarin nuk besonte të ishte i ati. Andaj, me gjithë lutjet e Demkës o të qarat e Xhemiles që të mos helmohet se ata e quajnë si bir të vërtetë, dëshmojti të shkonjë për të gjetur prindët.



Që atë ditë mori arratimet, duke pyetur më të gjitha anët, po ishin të kota gjithë kërkimet që bënte, se asnjë nuk dinte ç't'i përgjigjet, edhe atëhere i pashpresuar kthehet prapë edhe si mbushi 15 vjeç hyri në ushtëri të Kosturit.

Po tani Zëmbaku nuk ndjente me vete nonjë gaz, e brenga dita me ditë e thante si nonjë lule gjer kur e dërguan në Korçë, ku gjeti pakëzë prehje pranë kajmekamit.

## **PJESA E DYTË**

### **Krye III**

Meqënëqë mësuam se Zëmbaku ishte Rexhepi i Malos edhe i Vahidesë, duhet të mësojmë edhe fatin e Vahidesë më të Saftës, që i lamë në duart e Perëndisë, duke marrë udhën e perëndimit në ca zjarre që vështronin.

Ata zjarre që vështronte Vahideja i kishin ndezur një taraf evgjitësh, të cilët gjesdisnin me të gjitha anët e dheut, duke shitur tagarë, shosha, sita, e duke u lypur bukë njerëzisë që i gënjejnë me të gjetur fat ne pritmit.

Ata nuk kanë as mëmëdhe, as shtëpi, përveç se kasollet prej pëlhure, që i heqin me vete kudo që venë, edhe të cilat i ngrenë me vrap ku t'i zërë nata.

Kësisoj i kishte zënë hera atë natë në mest të udhës edhe, si ngritnë kasollet, ca prej syresh ranë të flenë, të tjerët rrinin rreth zjarrit, duke kuvënduar e duke thëthirë fundrat e çibukëve dhe të cigareve, që mblidhnin.

Një nga evgjitët, që kishte dalë jashtë, kthehet edhe u thotë:

— O shokë, një zjarr i math duket në Korçë edhe, pas flagëve që ndritnin, thom mos gjithë qyteti digjet!

— S'është për të habitur, — thotë një tjetër, — me këtë erë të marrë e të tmerruar munt të mos mbetet shtëpi më këmbë, se të këtillë zjarr s'më kanë parë sytë kurrë. Po vetëm Perëndia vëntë dorë e i shpëtoftë të gjorët korçarë, se janë më të mëshirçëm nga gjithë njerëzia!

Këto po fjalonin evgjitrit kur u çfaq në kasollet një grua e huaj, duke mbajtur një foshnje më krahë.

Qe të gjithë pandehnin të jetë prej farës së tyre pas të veshurit edhe pas fytyrës së zezë, po ata habiteshin se ajo ishte shumë më e çveshur nga ata. Andaj një plak evgjit, të cilin e kishte tarafi për krye, e pyeti:

— Nga na vjen, o motra jonë?

Po në vënt të çdo përgjigje, e huaja zuri të qeshnjë me ho! ho! edhe të lozë foshnjëri, duke kënduar.

Atëhere kuptuan evgjitrit që përpara syve kishin një të lojtur mëncë edhe besonin që ta këtë rrahur i shoqi sa humbi mëndjen. Andaj të helmuar për këtë gjë, e mbajtne në kasollet.

Poshnja që mbante në krahë ishte vashë e vogël prej mot-mot, pshjellë në ca pelena, edhe dukesh nga fytyra të mos shembëllënjë me farën e tyre, se ishte e bardhë si dbora edhe fort e bukur.

Grat e evgjitërve, që kishin foshnja, i epnin sisë meqënëqë e ëma, siç pandehnin të jetë ajo grua nuk i jepte, e blegërimave të foshnjes u përgjigjeshe me të qeshur.

Të nesërmet, si u hap dita mirë, mblodhë tendat edhe bashkë me gruan e prishur mëncë, muarë udhën të gjesdisin si gjithnjë katund më katund, duke lypur.

Kësisoj rrojti shumë kohë Vahideja me evgjitrit, që e quanin Flagëtare, meqënëqë i pëlqente zjarri me flagë shumë, edhe Safta të cilën e rritne evgjitkat duke e qojtur Manushaqe, se ish fort e bukur edhe e urtë.

Shkuan pesë vjet që kur gjëndeshin në taraf të evgjitërve edhe Vahideja s'kishte të vinjë nër mënt. Sa për Saftës, së cilës do t'i thomi Manushaqe, ajo nuk dinte gjësendi; lonte me foshnjat e evgjitërve, me të cilat ishte rritur. Po ajo sa rritesh, aqë zbukurohesh edhe nuk u shëmbëllente nga mënyrat e fëmijëve të tjerë, kur një ditë kishin ngrehur kasollet në udhë të Kosturit, shkon s'andejmi një kalorës, që vinte për në Kostur.

Me të afruar pranë kasollës kalorësi, gjithë evgjitrit u ngritnë më këmbë që t'i falën të huajit, se që më të pamet edhe më të veshurit dukesh të jetë njeri i madh, edhe fëmija iu derdhë përpara, duke kërkuar t'u apë gjësendi.

Kalorësi mbajti kalin edhe si ju ep kohën nxjerr qesen që t'u apë fëmijës të holla, të cilët pllakosnin njëri-tjatrën, duke zgjatur duart, kur vështron një vashë të vogël hequr mënjanë edhe që nuk afrohesh t'i apë edhe asaj.

Kjo vashë i bëri një verë të veçantë, aqë nga të sjellat, sa edhe nga fytyra e bukur, që nuk shëmbëllente me të evgjitërve, andaj pyeti të mësonjë e cilit evgjit ishte.

Evgjitërit i thonë është e huaj edhe nuk ka përveç t'ëmën të prishur mënç, e cila erdhi bashkë me të përpara 6 vjet, në nje natë kur rrinin në kasollet pranë zjarrit edhe siç e panë kësisoj e mbajtnë.

Kalorësit, me të dëgjuar këtë histori, i ardhi shumë keq për këta dy shpirtëra, që fati i kishte shpënë të rrojnë me evgjitrit, e duke psherëtitur sytë i lëshuan lotë, edhe tha me vete:

— Ja një të mirë që munt të bënj unë sot, edhe të shpaguej nga mëkatet që kam bërë. Andaj pa vonuar u thotë evgjitërve:

— U ap një qese me të holla edhe lermëni t’i marr.

Evgjitrin të kënaqur e prinë këtë tregëti të vleftë, se më një anë merrnin të holla edhe më tjetër anë shpëtonin nga kujdesi që të ushqejnë dy shpirta, andaj kalorësi, si hipi Flagëtaren me Manushaqen në kalë, shkoi përpara, duke hequr kalin për kapistre, dhe mori udhën për në Kostur.

Po cili ishte ky kalorës, njeri nuk e dinte, se me të vajtur në Kostur nuk hoqi në shtëpi si thoshte, po në një han, ku urdhëroi t’i lëshojnë dy dhoma për të ndenjtur. Të nesërmet, si u ngrit nga gjumi, i pari kujdes që kishte, ishte të veshnjë Flagëtaren edhe Manushaqen më rrobat të reja, e cila këcente nga gazi edhe harroi shokët që ishte rritur. Pastaj zuri një shtëpi për të ndenjtur edhe, si e shtroi me shtrofka e gjithë ç’duheshin, mori një shërbëtore edhe ndenjën në këtë shtëpi.

Për së shpejti bëri një të njojtur me fqinjët e me gjithë qytetarët, të cilët e nderonin shumë, edhe emri i Dervishit, siç e quanin, ishte nëpër gojë të popullit, për mirëbërësitë që bënte, si nuk kishte të vobekt a të varfër, a nonjë në të keq, që të vinte ne Dervishi edhe të mos i ndihte.

Shkuan, dhjetë vjet pas të vajturit në Kostur, Dervishin me Flagëtaren e me Manushaqen edhe nuk l kishin mësuar ç’njerës ishin e ç’lidhje kishin midis tyre, po për të bërët mirë të dobëve, emri i ti kishte arrirë e ish dëgjuar gjer në Kostandinopojë. Andaj qeveria e çojti kajmekam në Korçë si për njeri të drejtë.

## **PJESA E DYTË**

## Krye IV

Të këthehemi pakëzë të vështrojmë ç'u bë Rushan beu i cili ishte shkaku i gjithë këtyre të ligave!

Siç e pamë në krua të Abdi beut, pas zjarrit me Sulon edhe me Rushitin, hipnë kuajt që të tre, edhe i çkujdesur tani për nder të Oxhakut që nuk i turpërohet ose për Malon kur të kthehet nga lufta edhe do të mësonte fatin e Vahidesë e të djalit, pa dyshim besonte që do të vijë në shtëpi edhe të kërkonjë ndjesë, kështu duke menduar shkuan për në Frashër.

Po, sa ishte i gënjyer Rushan beu, kur premtonte (10) pasktaj fatbardhësi!

Ay duhesh të ndjenjë dorën e Perëndisë, që ajo zemra e patmerruar edhe e keqe të ndjenjë hidhërimin e jetës e dhëmkën e fëmijës. Andaj gjithë në atë kur ay kishte vajtur në Korçë, për t'i vënë zjarrin “shtëpisë së zezë” me shpresje që të humbasë ca shpirta pa faj, një gjemë e madhe e kishte ndjekur dhe pa arrirë në shtëpi mëson që djalin më të math ja kishin vrarë!

Që atë ditë zunë për Rushan benë brengat, helmet, zija, e gjithë të këqijat, ta ndjekin njëra pas tjetrës, dhe më dy vjet e sipër të mbetet një kërcu i thatë, se gjithë fëmija sa kishte ca ju vranë, të tjetër vdiqnë, sa gjer më së fundi i vdiq edhe gruaja!

Atëhere sa deshte të ketë e të pushtonjë gruan e djalin e Malos, të vetmin filis që munte t'i hapnjë Oxhakun edhe të mos i shuhet, po ata me dorën e ti i kishte djegur edhe bërë shkrump!

Andaj tani, veç brengavet edhe helmit ishte një gjë tjetër më e madhe, se vetëdija zuri t'i godinjë shpirtin e prehje të mos gjenjë as ditën as natën, se kudo që vinte, sa edhe

ndë gjumë, nuk vështronte përveç eshtra të djegura e të zhuritura, të cilat i çfaqeshin si hije duke thënë:

— Vështro therorët që bëre, Rushan be, edhe janë gjak prej gjakut tënt!

Në këto vështrime të pareshtura ngrihesh nga shtrati i tmerruar, duke bërëtitur si i prishur menç, me sy të zgurdulluar, me leshra si të ujkut, ngritur përpjetë, me gojën plot shkumbë, delte përjashta që t'i mërgonjë, po edhe atje nuk gjente prehje!

Një shpresje, që i kishte mbetur, ishte Maloja, po ay vononte të kthehet nga lufta, andaj i pashpresuar dëshmojti të shkonjë që ta gjenjë edhe t'i kërkonjë ndjesë për gjithë të ligat që bëri.

Gjithë kërkimet e pyetjet mbetnë të kota, se për Malon nuk i epnin asnjë lajme të vërtetë, edhe atëhere kthehet edhe, si merr me vete gjithë të hollat që kishte, shkon duke zënë arratimet e duke ndihur të vobekëvet, të varfërët, ku dëgjojnë që gjenden, me shpresje që Perëndia do t'i ndjenjë mëkatat edhe ta shpëtonjë prej kësaj jete!

Sot e kuptonte edhe ay që, në këtë botë, Oxhaku nuk ka vleftë gjësendi, se si ay që ishte Rushan bej, gjithashtu si ay edhe më i vobegti do të vdesë, po lum ay që mbahet mënt për të mirë edhe rron sa gjallë e me nder!

Andaj sot kishte arrirë nga tmerrri edhe nga frika e Perëndisë të ndryshonjë edhe emrin me një të rrem, të rronjë lark të njojturve nëpër arratimet, duke kërkuar të bënëjë vetëm të mira edhe t'i kërkonjë ndjesë Perëndisë për mëkatat që kishte bërë në jetë.

Perëndia është e madhe edhe zëmërgjërë, i ndjen kurdoherë ata më të liqtë që kthehen në udhë të së drejtës. Andaj i ndjeu edhe Rushan Beut mëkatat edhe e mësoi të marrë udhën e Kosturit ku do të gjente prehje.

Se ay kalorës, që qëndroi në Evgjitërit edhe mori Flagëtaren me Manushaqen, ishte Rushan beu, i cili shkoi në Kostur, ku rrojti 10 vjet gjersa e dërguan për kajmekam në Korçë.

Rushan beu nuk kishte nevojë për të këtitë shkallë edhe bukë, po një gjë e huaj e çpontë edhe parandjente që të presë këtë shkallë se do të muntnjë gjithë në ata vënde ku kishte bërë ato të këqia, të gjenjë prehje.

Edhe me të vërtetë tani kishte ndryshuar shumë si në të pamët, si edhe nga shpirti, që kur kishte marrë Flagëtaren me Manushaqen, edhe më shumë që kur i dërguan Zëmbaknë ofiqn' e ushtërisë, për të cilin kishte dashuri të veçantë edhe qëllim, andaj dëshmojti t'i bashkonjë me Manushaqen.

## **PJESA E DYTË**

### **Krye V**

Gjithë qytetarët e pritnë me gaz të madh këtë lajme të bukur për të vluarit e Zëmbakut me Manushaqen, se që të dy u kishin fituar zëmrat qytetarëvet, të cilët i donin shumë si edhe kajmekamin për urtësinë, drejtësinë, edhe për të mirat që bënte në të varfërit.

Që të gjithë e pëlqenin këtë par (11) të çkëlqyer, se si djali ashtu dhe vasha shëmbëllenin nga mënyrat, nga karakteri, nga bukuria, si edhe nga shpirti e nga zëmrat e drejta e të qëruara që kishin, andaj u uronin trashëgim të gjatë dhe fatbardhësi.

Dasma përgatiteshe me një rrëmbim të madh në shtëpi të kajmekamit, i cili dukesh fort i kënaqur për këtë martese të Zëmbakut me Manushaqen, se me të vërtetë pas

të vluarit të këtyre, një lehsim të math ndjente në shpirtin e tij, edhe më s'e godiste vetëdija për mëkatat që kishte bërë, andaj mentonte që pas dasmës t'u çfaqet cili është, e të nunoset për gjithë ç'kishte bërë edhe t'u apë emrin e tij edhe tërë pamjen.

Me tjatër anë, edhe Zëmbaku bënte përgatira për dasmë, edhe dërgoi e solli Demkën me Xhemilen nga fshati që të gëzohen edhe ata që e kishin rritur si djalin e tyre, se tani Zëmbaku i donte edhe më shumë se sa pa mësuar që nuk ishin ata prindër të vërtetë.

Po nuk ishin mbaruar mëkatat e Rushan beut, se me të zënë dëfrimet për dasmë e, duke mos mbetur përveç një javtë që të lidhin jetën për gjithnjë Zëmbaku me Manushaqen, një urdhër i naltë erdhi nga Qeveria, nga Konstandinopoja, që Arsllan hajduti, më 25 dite e sipër të jetë ja I vrarë, ja i falur!

Arsllan hajduti ishte fort i dëgjuar, po jo i tmerruar si të tjerët që u bënë dëm fshatarëve dhe udhëtarëve, se ay kishte një qëllim të shënjtëruar që t'u ndihnjë të vobekëvet edhe të mpronjë të drejtën, andaj prej dhjetë dymbëdhjetë vjet ishte hajdut e njeri nuk e trazonte, po sot qeveria kërkonte ja kryet e tij, ja të falet!

Rrufeja të binte nuk do të plagoste sa ky urdhërim zëmrat e Zëmbakut e të Manushaqesë e më shumë të gjorit kajmekam, i cili pandehte se iu sosnë mëkatat. Andaj qante si një foshnje duke menduar që nga shkakut e tij i ndjekin edhe të tjerët pa faj të këqiat.

Të qarat, helmi edhe brengat nuk kishin pushim, po kjo ishte urdhëratë e lartë prej qeverie, që duhesh mbushur sa më shpejt. Andaj Zëmbaku pa vonuar mbleth ushtarët e, si puthet me kajmekamin, me Manushaqen dhe me prindët e tij, Demkën e Xhemilen, të cilëvevet u derdheshin lotët çurkë, shkon të ndjekë Arsllan hajdutin.



Në këtë ndarje cilido që të ishte nuk munte të mbahesh edhe të mos qanjë për këta shpirtëra kaqë të dashur që ndaheshin. Edhe nuk dinin a do të hasen edhe një herë, andaj edhe Flagëtareja, e cila vetëm qeshte, sot qante kur puthi Zëmbakun.

Si u puthnë për të fundit herë, duke uruar të kthyer të shpejtë dhe ta mpronjë Perëndia nga rreziku, shkon Zëmbaku me ushtarët.

Por Arslani nuk ishte nonjë hajdut si të tjerët, i dobët, se ay kishte nën urdhër përveç 60 shokë të besës, gjithë fshatarakët, të cilët e donin shumë. Edhe ishte mjaft të nxjerrë një fjalë prej gojës që të rrëmbejnë armët kontra kujtdo që t' u thoshte. Andaj ishte një rrezik i math për Zëmbakun të lëftonte me kapedan Arslanin.

Më tjetër anë, Arslani nuk kishte një fole e një të ndenjtur, po ay gjesdiste më të gjitha anët e Toskërisë, ku aty, ku atje. Andaj pas shumë ditësh përpiqen të dy palët në Kolonjë, ku lëftuan burrërisht dy ditë pareshtur.

Lufta ishte fort e tmerruar më të dy anët, se lëftonin gjithë burrat shqiptarë, që nuk i tmerron plumbi edhe baruti, po më së fundi u muntën ushtarët edhe Zëmbaku ra i plagosur në duar të hajdutëve, pas një trimërie të madhe.

Të pakët ushtarë, që shpëtuan nga kjo luftë e tmerruar, u kthyen me vrap në Korçë që të lajmërojnë kajmekamin.

Hajdutët, si varruan me nder të varrët, muarë Zëmbakun më krahë edhe shkuan nëpër malet ku ishin në siguri prej qeverisë.

## **PJESA E DYTË**

### **Krye VI**

Që të mësojmë cili ishte Arslan hajduti, duhet të hedhim sytë aty dhjetë vjet përpara, në një natë kur gjithë njerëzia flinin, që të vështrojmë një njeri të vinjë në Korçë nga udha e Janinës.

Ky ishte veshur me fustanellë të bardhë si dëbora e gjithë klinda, anterinë qindisur me otrara të arta, mezë rrethuar me silahen e artë, në të cilën mbante armët, në këmbët me kallcat lidhur me tizga të mëndafshta dhe opingat të telatinta, një shpatë varur më të mëngjër, edhe permi të kishte hedhur një gunë të zezë e të gjatë.

Nga vërsa nuk dukesh të ish më shumë se 30—35 vjeç, leshrat e mustaqet të zeza, hundën të tretur si qiriri, gojën të vogël e të bukur, edhe një trup të derdhur. Dukesh fatbardhës pas fytyrës edhe fort i kënaqur kësaj jete, se buzët i nënqeshnë me të arrirë në krua ta gjenjë tani të math e të bukur.

Ky kthehesh nga lufta, ku kish vajtur për mbretërinë të lëftonjë grekërit, që ishin ngritur asi kohe. Andaj, si ndezi një cigare ngrihet e merr udhën të vejë në shtëpi, prej së cilës ishte ndarë 6 vjet përpara, duke lënë gruan e një djalë që e dëshëronte edhe të cilin besonte ta gjenjë tani të math e të bukur.

Këto mentonte duke shkuar, po gazi i math, që ndjente në zëmër të tij, u kthye në helm, edhe prej asaj fytyre të bukur e të çelur dollën psherëtima, me t'u afruar në atë vënt ku ishte një herë “shtëpia e zezë”, se tani nuk shihte përveç një gërmadhë prej gurësh dhe mbeti i tmerruar përpara kësaj pamjeje.

Sytë iu mbushnë me lot, deshte të bërtasë ca emra të shtrenjta, po nuk munte pa mësuar për fatin e kësaj shtëpie. Andaj pa vonuar troket ne porta e një fqinje që ta lajmëronjë.

Atje kur mëson që shtëpia u doq bashkë me gjithë ca njerës që ishin brënda, të cilët nuk i dinin as i njihnin, ra si i vdekur përdhe, duke bërtiturë: Vahide, Rexhep i dashur!

Kur erdhi në vete lotët i pikonin nga sytë edhe, pa nxjerrë nonjë fjalë, ngrihet përnjëhere edhe shkon duke lënë të huajnë të habitet vetvetiu për këtë shkak që nuk e kuptonte.

I tmerruar edhe si i prishur menç shkojti, po ku vinte as ay s'e dinte i gjori, kur duke ikur arriu në mëngjes në grykë të Qarit. Atje qëndrojti pakëzë të çlodhet, duke thënë: që sot e tutje Maloja i Rushan beut, është i vdekur bashkë me Vahidenë edhe me Rexhepkën, se nuk ishte tjetër përveç Malos, i cili kthehesh nga lufta edhe me gaz edhe me njëmijë gëzime pranë atyre që i donte më shumë se çfarëdo ndë jetë. Andaj meqënëse sot këta ishin të vdekur, jeta e qytetërisë dhe e prindërve ishte mbyllur për gjithnjë, edhe dëshmojti të shkonjë jetën paskëtaj nëpër malet si hajdut me emrin Arsllan.

Pas pak kohë mblodhi mjaft Shokë edhe gjesdiste mi gjithë anët e Toskërisë, jo që t'u bënë dëme e të liga njerëzisë e udhëtarëve, si të tjerët hajdutë që ishin ata më të poshtërit kusarë, po për të mprojtur edhe për të ndihurë të dobëtët edhe të vobekëvet, që ishin nën fuqi të të mbëdhenjëve, të cilët kërkonin t'u rjepën edhe lëkurën e trupit.

Me këto të sjella fitoi në pak kohë dashurinë e popullit, se njerëzia zunë të rrojtë të qetë, duke mos u drojtur nga të mbëdhenjtë, të cilët tani dridheshin nga tmerri i Arsllanit edhe s'guxonin të rjepin si më parë popullin, po kërkonin fshehtazi humbjen e këti hajduti, që emri i kishte arrirë gjer në Konstandinopojë!

Kajmakami i Korçës, mëqënëqë shihte se Arsllanit i pëlqente e drejta, kurrë nuk qëllonte ta ndjekë edhe ta trazonjë edhe, pa e njohur këtë hajdut, e donte edhe e nderonte.

Andaj i erdhi shumë keq kur mori urdhërin nga qeveria, të cilën e çponin të mbëdhenjtë, që s'guxonin të rjepin, duke çpifur që Arsllani qëllon të ngrerë vëndin. Po kur e dërgojti Zëmbakun e porositi mënjane që të kërkonjë ta bintnjë Arsllanin të falet.

Po Arsllani më mirë deshte vdekjen sa të falej e të rronjë në mes të njerëzisë, për të cilët kishte tmerr. Andaj nuk priti të falurit, po luftën, në të cilën ra i plagosur Zëmbaku në duar të tyre.

Si e shpunë në malt, me gjithë lutjet e Arsllanit që ta lironin, e gjykuan shokët për të vrarë, mëqënëqë ca nga ata thoshin që u ka vrarë vëllezërit edhe të dashurit.

Pas zakonisht që kishin, si e gjykuan, i lithnë sytë që të mos vështronjë edhe dhjetë hajdutë, më dhjetë pash lark, prisnin me armët ngrehur në dorë që të urdhëronjë kapedani zjarr! Kur Zëmbaku i cili qëndronte me kryet ngritur edhe i patmerruar që afrojtë ora e fundit, i kërkon një falje kapedanit.

Si edhe cilido shqiptar të jetë do t'i mbushnjë vullnesën, sado armik që t'i jetë, kur i kërkon falje në orë të fundit, kapedani mbajti shokët që të mos heqën zjarr edhe pyet të lidhurin:

— Cila është vullnesa e fundit që kërkon të ta mbush?

Zëmbaku atëhere nxjerr një hajmali të artë, që kish varur në qafë, edhe i thotë:

— Kapedan! falja që të kërkonj nuk është tjetër përveç i kësaj hajmalie, të cilën të lutem të ma vini bashkë me mua në varr, se saqë gjë kam edhe unë për kujtim nga prindët, që s'i mbanj mënt edhe s'i njoh, mëqënëqë më lanë të vogël e të varfër!

Kapedani, me t'u afruar pranë Zëmbakut edhe me të hedhur sytë përmi hajmalinë si vetëtima e përqafoi duke thënë:

— Rexhepi im i dashur!

Hajdutët të gjithë si edhe Zëmbaku mbetnë të habitur për këtë ngjarje që s'e kuptonin; po Arsllani, si erdhi në vete, duke puthur Zëmbakun e duke qarë si një foshnje që do t'i vritësh përpara syvet të ti, i lajmëron që ay është i biri, se hajmalinë ja kish varur vetë pa ikur, edhe e njihte pas një shënimi që kishte në faqe të djathtë.

Gazi ishte i madh, jo vetëm mi Arsllanë e mi Rexhepin, po mi gjithë hajdutërit, se ata e donin shumë kapedanin dhe e dëgjonin. Andaj pa vonuar dëshmonjtën të gjithë që, bashkë me kapedanin, të venë në Korçë e të falën, që të mundin edhe nëpër qytet t'i sjellin gjithë atë shërbim së drejtës!

## **PJESA E DYTË**

### **Krye VII**

Të lëmë pakëzë hajdutët me Rexhepin udhës e të kthehemi të shohim ç'bëhet në shtëpi të kajmekamit.

Pas të ikurit të Zëmbakut, të cilit që tani e tutje do t'i themi edhe Rexhep, kajmekami ndë një brengë të madhe kërkonte të mbetej vetëm, duke u mbyllur në dhomë e duke mos kuvënduar me tjetër njeri, përveç Manushaqes, që me gjithë helmin që ndjente për Rexhepin kërkonte t'i mërgonjë brengën kajmekamit, të cilin e gjente gjithnjë të qanjë.

Shkaku i kësaj brehge edhe të qarave ishte Rexhepi, se tani i shkonte nër mënt e nëmëronte një nga një sa kishte bërë edhe sa kishte vuar në jetë, se pa që e larguara e Rexhepit ishte më shumë se vdekja, meqë nuk dinte ç'fat do të kishte.

Andaj mendonte të ligat e zinte të mallkonjë veten e ti, se pandehte që mëkatat e tija ndjekin edhe Rexhepin, të cilin pas martesës qëllonte ta bënë djalë edhe t'i apë emrin që të mos shuhet Oxhaku. Edhe Manushqja, siç e dimë, ishte e huaj edhe nuk kishte nonjë lidhje me kajmekamin si edhe me Flagëtaren, të cilën e pandehte edhe Manushaqja se ishte e ëma e saj.

Por për fat të keq, iku edhe Rexhepi që të ndjekë hajdutët, edhe për kajmekamin nuk kishte mbetur tjetër shpresë përveç vdekjes, të cilën e kërkonte ditë e natë duke qarë.

Në këtë kohë, sa ishte mërguar Rexhepi prej kajmekamit, nuk kishte mbetur përveç një skelet edhe sa vinte tretesh si qiriri, duke mos ngrënë gjësendi e duke mos fjetur, po më e madhja ishte kur u kthyen të pakët ushtëtarë, që kishin shpëtuar nga lufta edhe kur mësojti që Rexhepi i plagosur ishte në duart e hajdutëvevet.

Me të dëgjuar këtë lajme të zezë, e cila i dukesh më e madhe se gjithë dhëmkat e të këqiat që e kishin ndjekur gjer më sot, goja iu nemit, fytyra iu bë plehë, sytë iu terë, qafa iu var edhe ra si i vdekur mi minder.

Pas shumë fërkimesh të Manushaqesë, e cila më një anë qante me blegërim për të dashurin Rexhep, më tjetër anë për kajmekamin, që e donte si atë të vërtetë, erdhi në vete edhe hapi sytë, duke i hedhur më të gjitha anët, edhe, si pa që është pranë Manushaqes e Flagëtares që rrinte mënjanë, i shtrëngon dorën edh' i thotë:

— O bija ime e dashur! E shoh që ora e fundit afro, andaj pa dhënë shpirtin, dua tynë të të nunosem për gjithë mëkatat që kam bërë, që tinë shpirtdrejtë t'i lutesh Perëndisë për mua të m'i ndjenjë.

Atëhere zuri t'i tregonjë që ay ishte Rushan beu edhe sa kishte bërë në jetë.

Manushaqja, që nuk dinte gjësendi edhe nuk e shkonte për mënt që kjo histori ishte lidhur me të sajnë, mori përsipër që sa ka për të rojtur do të kërkonjë Malon, të cilin do ta dojë për atë edhe për vëlla, duke ndarë gjithë begatinë që i linte Rushan beu.

Në këtë përflim Flagëtarja, me të dëgjuar këta emra, ngrihet nga vëndi e tmerruar duke murmuritur: Maloja në luftë... Rexhepi në zjarr... Rushan beu... ha! ha! edhe zinte të qeshnjë.

Rushan beu, të cilit paskëtaj do t'i thomi kajmekami, me Manushaqen habiteshin për Flagëtarën, e cila për të parën herë hapi gojën e murmuriste këta emra, kur dëgjohej shumë zëra përjashta në oborr.

Po, sa të mësojnë cilët ishin këta njerës në oborr; dera hapët përnjëherësh edhe çfaqet Rexhepi me një njeri tjetër, i cili pas fytyrës edhe pas të veshurit, dukesh të jetë hajdut.

Rushan beu si vetëtima në këtë pamje të pashpresuar ngrihet më këmbë, e duke derdhur lotët çurkë e përqafton Rexhepin.

Rexhepi i merr dorën e, duke e puthur me nder prindërisht, i thotë:

— Jam i kënaqur sot të të puth dorën e të thom që meritonj të bëhem burri i Manushaqes, meqënëqë sot kam një emër, edhe një emër të çkëlqyer, se Arsllan hajduti i cili vështron këtu, që erdhi të falet me shokët, është ati im, edhe është nga oxhakët më të mbëdhenj e të çkëlqyer të Shqipërisë, se nuk quhet Arsllan, po Malo, i biri i Rushan be Frashrit!!

Si dhemka edhe helmi ashtu edhe gaz i math e vret shumë herë njerinë, po Rushan beu u forcua në këtë sihariq të pashpresuar e të vleftë edhe i pushton që të dy në krahë, duke kënaqur Perëndinë që i ndjeu mekatat edhe nuk i mbylli Oxhakun.

Gazi ishte i patreguar e lotët derdheshin çurkë si lumë, po gazi ishte edhe më i math kur Flagëtarja erdhi nër mënt me të njojtur Malon edhe Rexhepin. Andaj Rushan beu u kërkoi ndjesë se ay ishte shkaku i gjithë të vojturave.

Manushaqja vërtet e gëzuar për këtë ngjarje të bukur, po tani rrinte hequrë mënjanë, duke mos kuxuar të afrohet, se pandehte që ishte prerë tani çfarëdo shpresë që të arrinjë e të bëhet gruaja e Rexhepit, i cili ishte një prej oxhakëve të mbëdhenj, kurse ajo një e varfër në botë!

Po Rushan beu, me t'u çkëputur nga të përqafosurit prej Malos, Rexhepit edhe Vahidesë edhe me të hedhur sytë përmi Manushaqen, e pushton, duke thënë:

— Bija ime e dashur! Që sot do të të dua edhe më shumë, se unë të kam bërë të varfër. Andaj me emrin e bukur Manushaqe, me të cilin më solle prehjen e shpirtit edhe gjithë këto të mira, që këtë javë do të zëmë dasmën që t'ju shoh sa më shpejt bashkuar me të dashurin Rexhep gjithnjë edhe të më shtoni "Oxhakun"!

## **PJESA E DYTË**

### **Krye VIII**

Si vetëtima, u-përhap më gjithë anët e Shqipërisë kjo lajme. Andaj me të dëgjuar njerëzia vrapuan në Korçë që itë marrin anë edhe ata në këtë gaz.

Se si kajmekamin edhe Rexhepin qytetarët donin edhe Malon, i cili me emrin Arslan hajduti kishte fituar dashurinë e gjithë Toskërisë me punërat e mira që bënte në popull.



Dëfrimet ishin të pasosur në shtëpi të Rushan beut për dasmën e Rezhepit me Manushaqen, në të cilën muarë anë gjithë qyteti edhe të ardhurit që përjashta. Po dita më e bukur edhe më e çkëlqyer ishte ajo ditë, kur si u lidhi hoxha, pas fesë, dashuri për jetë, duallë nëpër qytet të shëtimit rradhitur kësisoj: Në krye Rushan beu çkëlqente prej gazi, pas ti vinte Manushaqja në mes të Vahidesë e të Malos, pastaj Rexhepi në mes të Demkës e të Xhemiles, të cilët nuk i ndau kurrë sa rojtnë, edhe prapa, ishin hajdutët me rrobat sterrë të zeza, që ishin falur me kapedanin e dashur.

Gjithë njerëzia të gëzuar u uronin trashëgim të ëmbël edhe fatbardhësi të rinjve.

Si shkuan pesë vjet pas martesës së Rexhepit me Manushaqen në fatbardhësi e duke shtuar Oxhakun me një djalë, që e quan Arslan, edhe me një vashë të bukur, Rushan beu u plak edhe, si i përqafoi e i puti, i uroi duke thënë: Unë do të vdes, fëmija ime e dashur po sot jam i kënqur se mbyll sytë i gëzuar. Andaj Perëndia u falte fatbardhësi e jetë të gjatë, po, sa gjallë e me nder, të punoni edhe të doni të drejtën e të mirën e Shqipërisë, edhe rrofshi e qofshi dhe nderofshi “Oxhakun”.

- (1) ta laknjë — të lahej.
- (2) i lanë të lirë.
- (3) shtëpresë — nikoqirë të mirë.
- (4) dëshmim — vendim.
- (5) pendim — këtu në kuptimin dyshim.
- (6) shtrofkat — shtresat.
- (7) vërimet — betimet.
- (8) vërejë — vrime.

(9) në shkallë të bukës — në shkallë të nëpunësisë.

(10) premtonte — këtu: priste.

(11) par — çift.